

William R. Hite, Jr., Ed.D.
Superintendent

22 Mars, 2022

Të Nderuara Familje të Drejtorise Arsimore të Filadelfias,

Sot, Drejtoria Arsimore e Filadelfias njoftoi nisjen e procesit të saj “ Facilities Planning Proçes” (FPP), duke shënuar një hap kritik drejt realizimit të vizionit të saj për të gjithë fëmijët të kenë qasje në një shkollë të mirë. Ndërtesat shkollore luajnë një rol vendimtar në mbështetjen e arritjeve të studentëve kështu që ne mendueshëm dhe në mënyrë proaktive duhet të planifikojmë jo vetëm për ndërtesat për shkollat e reja, por për atë që duhet të bëhet me ndërtesat tona ekzistuese shkollore në mënyrë që studentët të kenë qasje në mjedise që frymëzojnë krijimtarinë e të mësuarit, të mbështesin programet akademike, dhe realizojne nevojat e të mesuarit të Shekullit të 21-.

Proçesi fillon me vlerësime intensive të nivelit të shkollës, të udhëhequra nga ekspertë të industrisë, të cilat së bashku ofrojnë një vështrim strategjik, të gjerë të sistemit të ndërtesave dhe programeve tona ekzistuese të shkollave dhe se si popullsia dhe komunitetet në të gjithë qytetin tonë parashikohen të ndryshojnë në vitet e ardhshme. Këto të dhëna përdoren për të identifikuar vështirësitë specifike me të cilat ballafaqohen ose pritet të përballen ndërtesat tona shkollore në vitet e ardhshme, dhe për të dhënë rekomandime për të adresuar këto vështirësi si pjesë e “ Facilities Master Plan” të Objekteve afatgjata të Drejtorisë . Ky plan, i cili do të jetë i disponueshëm në pranverën e vitit 2023, do t'i japë prioritet shpenzimeve për investime që përafrojnë mjediset e të mësuarit me komunitetin në zhvillim, objektet dhe nevojat arsimore.

Planifikimi i objekteve është një proçes që ne jemi të përkushtuar ta bëjmë në partneritet me familjet tona dhe komunitetet shkollore. Për përpjekjet tona fillimit të angazhimit, ne ftojme të gjithë anëtarët e komunitetit tonë për të marrë pjesë në një nga tetë Bisedat e Komunitetit nga datat 10 – 25 Maj, 2022, ku mund të mësoni më shumë rreth FPP-së, të merrni një pasqyrë të nivelit të lartë të të dhënave që përdoren në proçes dhe të ndani mendimet mbi atë që Drejtoria duhet të marrë parasysh kur merr vendime për objektet. Për t'u regjistruar për një nga këto seanca dhe për të mësuar më shumë rreth FPP, ju lutem vizitoni philasd.org/facilitiesplanning.

Mezi presim t'ju shohim në një Bisedë të ardhshme në Komunitet.

Sinqerisht,



William R. Hite Jr., Ed.D.

Superintendent
Drejtoria Arsimore e Filadelfias

(Albanian)